



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.88

29 qershor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.331, datë 14.4.2011	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”.....	3639
Vendim i KM nr.391, datë 1.6.2011	Për miratimin e statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.	3654
Udhëzim i MD, MB nr.3880/3, datë 3.6.2011	Për procedurat e bashkëpunimit të shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror me Policinë e Shtetit	3661

VENDIM
Nr.331, datë 14.4.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE RADIO DHE FUNDORE TË
TELEKOMUNIKACIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, si dhe të nenit 5 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
**PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE RADIO
DHE FUNDORE TË TELEKOMUNIKACIONEVE**

1. Fusha e zbatimit

1.1 Ky rregull zbatohet për:

- pajisjet e radiokomunikimit;
- pajisjet fundore të telekomunikacioneve.

1.2 Ky rregull zbatohet, gjithashtu, për aparatet sipas përcaktimit në pikën 2, kur ato përfshijnë si një pjesë të tërë ose si aksesori:

- një pajisje mjekësore; ose
- një pajisje mjekësore aktive transplantimi.

1.3 Ky rregull përcakton kërkesat thelbësore në veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe vënies në shërbim të pajisjeve radio e të pajisjeve fundore të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë. Ky rregull zbatohet për të gjitha pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.

1.4 Ky rregull teknik nuk zbatohet për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve të listuara në aneksin 1.

1.5 Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet që përdoren ekskluzivisht për aktivitete që lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe aktivitetet e shtetit në fushën e aplikimit të ligjit kundër krimit në Republikën e Shqipërisë.

1.6 Nuk pengohen apo krijohen pengesa për shfaqjen në panairë, ekspozita e në demonstrime të aparateve që nuk janë në përputhje me këtë rregull, me kushtin që një shënim i qartë dhe i dukshëm tregon që një aparat i tillë nuk mund të vendoset në treg apo në shërbim pa u sjellë në përputhje me këtë rregull teknik.

1.7 Ky rregull zbatohet për fabrikuesit, përfaqësuesit e autorizuar të fabrikuesve, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në tregun shqiptar dhe nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike (kur blerja bëhet prej tyre jashtë tregut shqiptar).

2. Përkufizime

Për qëllimin e këtij rregulli termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Aparat” do të kuptojmë çdo pajisje që është ose pajisje radioje, ose pajisje fundore e telekomunikacioneve, ose që të dyja.

“Klasa të pajisjeve” do të kuptojmë një klasë që identifikon tipa të caktuar të aparateve, të cilët sipas këtij rregulli konsiderohen të ngjashme, si dhe ato ndërfaqe për të cilat aparati është projektuar. Aparatet mund t’i përkasin më shumë se një klase të pajisjeve.

“Klasa 1” do t’i referohet pajisjeve, të cilat mund të vendosen në treg dhe të vendosen në shërbim pa kufizime sipas këtij rregulli.

“Klasa 2” do t’i referohet pajisjeve për të cilat janë aplikuar kufizime gjatë vendosjes në treg ose vendosjes në shërbim sipas këtij rregulli.

“Pajisje radioje” do të kuptojmë një produkt, ose komponent të caktuar, i aftë për komunikim me anë të emetimit dhe/ose marrjes së valëve radio, duke përdorur spektrin e përcaktuar për radiokomunikim tokësor/hapësinor.

“Pajisje fundore të telekomunikacioneve” do të kuptojmë një produkt që mundëson komunikimin ose një komponent të caktuar që ka si qëllim lidhjen direkt ose indirekt në çfarëdolloj mënyre në ndërfaqet e rrjeteve publike të telekomunikacioneve.

“Ndërfaqe” do të kuptojmë një pikë lidhjeje fizike fundore të rrjetit, në të cilën i ofrohet akses në rrjetin publik të telekomunikacioneve një përdoruesi, dhe/ose një ndërfaqe që specifikon një lidhje radio midis pajisjeve radio.

“Dokumentacioni teknik” do të kuptojmë dokumentacionin që përshkruan një pajisje dhe që ofron informacione dhe shpjegime se si janë implementuar kërkesat thelbësore.

“Brez frekuence i harmonizuar” do të kuptojmë brezin e frekuencave, i cili në të gjithë ose në pjesën më të madhe të vendeve europiane është i parashikuar për përdorim për pajisjet radio me veçori të njëjta teknike (radiofrekuenca, modulimi, fuqia etj.).

“Valë radioje” do të kuptojmë valët elektromagnetike të frekuencave nën 3000 GHz të përhapura në hapësirë.

“Interferencë e dëmshme” do të kuptojmë interferencën, e cila rrezikon funksionimin e një shërbimi të radiodrejtimit, ose të shërbimeve të tjera të sigurisë, ose që nga ana tjetër degradon seriozisht, pengon ose ndërpret në mënyrë të përsëritur një shërbim të radiokomunikimeve, të cilat operojnë në përputhje me radiatorregulloret e ITU ose rregulloret kombëtare.

“Organizëm europian i notifikuar” është një organizëm i vlerësimit të konformitetit, i njohur nga Komisioni Europian dhe i regjistruar në faqen e tij zyrtare si një trup kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të konformitetit.

3. Kërkesat thelbësore

3.1 Për të gjitha pajisjet brenda fushës së këtij rregulli, aplikohen këto kërkesa thelbësore:

a) Mbrojtja e shëndetit dhe siguri i përdoruesit, si dhe i çdo personi tjetër, duke përfshirë edhe objektivat lidhur me kërkesat e sigurisë, por pa aplikimin e një vlere limit të tensionit, sipas rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.369, datë 27.3.2008 “Për miratimin e rregullimit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorimin brenda disa kufijve të tensionit””.

b) Kërkesat mbrojtëse lidhur me pajtueshmërinë elektromagnetike, sipas rregullave të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 18.6.2008 “Për miratimin e rregullimit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike””.

3.2 Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 3.1 më sipër, pajisjet radio duhen ndërtuar në mënyrë të tillë, që të përdorin efektivisht spektrin e përcaktuar për burime radiokomunikimi tokësore/hapësinore dhe orbitale, në mënyrë që të shmangen interferencat e dëmshme.

3.3 Për aparate brenda një klase të caktuar të pajisjeve ose aparatet e tipave të veçantë, ministri përgjegjës për telekomunikacionin, mund të kërkojë përmbushjen e kërkesave specifike të mëposhtme:

a) konstruktimin që të bashkëveprojnë me anë të rrjeteve me aparate të tjera dhe që të mund të lidhen në ndërfaqe të tipave të përshtatshëm në treg; dhe/ose

b) konstruktimin që të mos dëmtojnë rrjetin, funksionimin e tij, ose të mos keqpërdorë burimet e rrjetit, që mund të shkaktojnë një degradim të papranueshëm të shërbimit; dhe/ose

c) të përfshijnë masa mbrojtëse, për të siguruar që të dhënat personale dhe fshehtësia e përdoruesit dhe e abonentit të jenë të mbrojtura; dhe/ose

d) të mbështetin cilësi të caktuara, duke siguruar shmangien e mashtrimit; dhe/ose

e) të mbështetin cilësi të caktuara, duke siguruar akses në shërbimet e emergjencës; dhe/ose

f) të mbështetin cilësi të caktuara në mënyrë që të thjeshtohet përdorimi i tyre nga përdoruesit me aftësi të kufizuara.

4. Vendosja në treg

4.1 Pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve mund të vendosen në treg vetëm në qoftë se plotësojnë kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik dhe kur ato janë instaluar siç duhet dhe mirëmbajtur e përdorur për qëllimin e synuar.

4.2 Aparatet, që janë në pajtim me kërkesat thelbësore, mund të vendosen në treg nga një person fizik ose juridik.

4.3 Fabrikuesi ose personi që vendos në treg aparatën është përgjegjës për të siguruar që aparati është në përputhje me këtë rregull teknik.

4.4 Importuesi, ose personi i cili sjell aparatën nga jashtë Shqipërisë dhe e vendos atë në treg, mban të njëjtat përgjegjësi si fabrikues dhe duhet të sigurojë që produkti është në pajtim me këtë rregull teknik.

4.5 Personi përgjegjës për vendosjen në treg të aparateve është i detyruar t'i japë përdoruesit instruksionin e përdorimit në gjuhën shqipe, si dhe një fotokopje të origjinalit të deklarimit të konformitetit me kërkesat thelbësore.

4.6 Kur aparati vendoset në treg duhet të ketë të fiksuar markën përkatëse të konformitetit.

4.7 Kur pajisja radio vendoset në treg, informacioni rreth qëllimit të përdorimit duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u identifikuar në paketim dhe në instruksionet e përdorimit të pajisjes, si dhe të njoftojë përdoruesin me anë të identifikuesit të klasës së pajisjes, për kufizimet potenciale të përdorimit të pajisjes radio në vende të caktuara.

4.8 Kur pajisja fundore e telekomunikacionit vendoset në treg, informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar ndërfaqet në rrjetin publik të telekomunikacioneve, të cilat pajisja është lidhur. Për të gjitha aparatet ky informacion duhet të shfaqet në mënyrë të dukshme.

4.9 Për të garantuar sigurinë e përdoruesit, fabrikuesi ose personi përgjegjës për vendosjen e aparateve në treg, duhet të zbatojë detyrimet sipas ligjit nr.9779, datë 16.7.2007.

4.10 Në rastin e pajisjeve radio, fabrikuesi ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjeve në treg është i detyruar të njoftojë AKEP-in për njohjen e konformitetit, sipas përcaktimeve të pikës 5. Një detyrim të tillë e ka edhe tregtuesi i këtyre pajisjeve.

4.11 Në përcaktimin e kërkesave sipas pikës 3.3 më sipër, ministri përgjegjës përcakton një periudhë të arsyeshme kohore për përmbushjen e tyre për pajisjet e vendosura në treg për herë të parë para datës së përcaktimit të këtyre kërkesave të veçanta.

5. Procedura e njohjes së konformitetit

5.1 Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është përgjegjës për njohjen e konformitetit për pajisjet radio të telekomunikacioneve që punojnë në breza frekuencash jo të harmonizuara.

5.2 Fabrikuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi ose personi përgjegjës për vendosjen në treg të pajisjeve radio, duhet të njoftojë AKEP-in për njohjen e konformitetit përpara importimit dhe vendosjes në treg për herë të parë të pajisjes/eve radio që punojnë në breza frekuencash jo të harmonizuara.

5.3 Procedura e përcaktuar në pikën 2 më sipër, duhet të zbatohet nga çdo person fizik dhe juridik, nëse është publik ose privat, vendas ose i huaj. Subjekti aplikant është i detyruar të njoftojë AKEP-in, së paku katër javë përpara importimit dhe vendosjes së pajisjeve radio në tregun shqiptar.

5.4 Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për pajisjet radio, që synohet të prodhohen, importohen, vendosen në treg, me përjashtim të pajisjeve radio që punojnë në frekuenca të harmonizuara, të përfshira në listën e publikuar sipas pikës 5.6.

5.5 Në Republikën e Shqipërisë mund të importohen dhe të vendosen në treg pa njoftim, pajisjet, të cilat përfshihen në grupet e pajisjeve, si më poshtë:

- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që i bashkëngjiten rrjetave fikse;
- pajisjet radio jotransmetuese;
- pajisjet radio, si p.sh., telefonat GSM, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti.

5.6 AKEP-i harton një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të pajisje të klasës 1, lista e pajisjeve do të jetë e prezantuar nëpërmjet faqes zyrtare të AKEP-it në internet: www.akep.al.

5.7 Procesi i njohjes së konformitetit është, gjithashtu, i detyrueshëm për subjektet përdoruese të pajisjeve radio, të cilat për herë të parë importohen direkt prej tyre nga jashtë Shqipërisë.

5.8 Formulari i njoftimit duhet të jetë sipas aneksit 8, bashkëlidhur këtij vendimi (në gjuhën shqipe ose angleze), të cilat mund të sigurohen në internet në faqen zyrtare të AKEP-it: www.akep.al.

5.9 Formulari i njoftimit duhet të përmbajë informacion për karakteristikat radio të pajisjes, në veçanti për brezat e frekuencave, hapësirën e kanalit, llojin e modulimit dhe fuqinë RF në dalje, si dhe numrin e identifikimit të organit të autorizuar/organizmit evropian të notifikuar, i cili është përfshirë në vlerësimin e konformitetit të pajisjes. Organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar nuk i bën publike informacionet e fituara gjatë procesit të njoftimit.

5.10 Njoftimi i dërguar nga aplikanti dhe dokumenti i lëshuar për njohjen e konformitetit:

- nuk do të thotë aprovim i përdorimit të pajisjeve radio në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- nuk garanton lëshimin e një autorizimi për përdoruesin dhe për vendosjen në operim të pajisjes radio;

- nuk e lehtëson aplikantin nga detyrimet e tij sipas këtij rregulli.

5.11 Dokumentacioni bashkëngjitur me formularin e njoftimit duhet të jetë, si më poshtë:

- përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike, sipas dokumentacionit të fabrikuesit, ose raportet e testimit;

- deklarata e konformitetit e lëshuar nga fabrikuesi, sipas këtij rregulli teknik dhe/ose opinioni i organit të autorizuar/organizmit evropian i notifikuar, nëse ai është parashikuar nga procedurat e vlerësimit të konformitetit.

5.12 Vlefshmëria e certifikatave dhe e raporteve të testimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit, të cilat kryejnë aktivitet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet sipas përcaktimeve të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007.

5.13 Formulari i njoftimit konsiderohet të jetë i plotësuar, kur të gjitha kërkesat lidhur me formën dhe përmbajtjen e tij janë plotësuar. Ky konsiderohet si momenti i fillimit të procesit të njohjes së konformitetit.

5.14 Në procesin e njohjes së konformitetit duhet të merret, gjithashtu, në konsideratë plani kombëtar i radiofrekuencave, duke refuzuar njohjen e konformitetit për pajisjet radio që përdorin breza radiofrekuence, të cilët në këtë plan janë përcaktuar për qëllime të tjera.

5.15 Në bazë të njoftimit të marrë dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij, AKEP-i pasi shqyrton nëse plotësohen konditat për importimin dhe/ose vendosjen në treg të pajisjes radio, sipas këtij rregulli, konfirmon njohjen e konformitetit.

5.16 Në rastin e mospërputhjes me kushtet e paraqitura në këtë rregull teknik, AKEP-i informon subjektin aplikant, që pajisja radio përkatëse nuk mund të përdoret në Republikën e Shqipërisë. Çdo refuzim për njohjen e konformitetit të një pajisjeje radioje duhet të jetë i motivuar.

5.17 AKEP-i mund të refuzojë aplikimin për njohje të konformitetit, nëse është e ndaluar vendosja e një pajisjeje të caktuar radioje në tregun e Bashkimit Evropian.

5.18 Pajisja radio e parashikuar për t'iu nënshtruar procesit të njohjes së konformitetit, mund të importohet dhe vendoset në treg vetëm pas lëshimit të dokumentit përkatës të njohjes së konformitetit.

5.19 Vlefshmëria e njohjes së konformitetit është e kufizuar vetëm për tipin e pajisjes radio të njoftuar.

5.20 Njohja e konformitetit nuk përfaqëson një certifikatë vlerësimi të konformitetit të pajisjes radio me kërkesat thelbësore.

5.21 Njohja e konformitetit të pajisjeve radio mund të revokohet kur provohet shkelja e kërkesave thelbësore të specifikuara në deklaratën e konformitetit, të lëshuar nga fabrikuesi, ose kur është vërtetuar përdorimi i tij jo në pajtim me planin kombëtar të radiofrekuencave dhe me specifikimet teknike të njoftuara nga aplikanti.

5.22 AKEP-i përditëson listën e publikuar të pajisjeve radio për të cilat është lëshuar njohja e konformitetit në faqen zyrtare www.akep.al.

5.23 Përgjegjësia për sigurinë, funksionimin, cilësinë dhe besueshmërinë e pajisjeve radio sipas kërkesave thelbësore për të cilat është lëshuar njohja e konformitetit, bie plotësisht mbi subjektet që e kanë marrë dokumentin e njohjes së konformitetit.

5.24 Operatorët janë të detyruar të lidhin në rrjet vetëm pajisje radioje, të cilat kanë kaluar procesin e njohjes së konformitetit.

5.25 Konfirmimi i njohjes së konformitetit për pajisjet radio bëhet në gjuhën shqipe ose angleze, sipas modelit të paraqitur në aneksin 9 të këtij rregulli.

5.26 Procesi i njohjes së konformitetit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio të aplikantit fillestar të njoftimit, me kusht që të jenë identike me atë që është njoftuar.

5.27 Njohja e konformitetit, e cila i lëshohet për herë të parë një subjekti aplikant, është e vlefshme edhe për çdo subjekt tjetër, i cili ka në zotërim pajisje radio të të njëjtit tip. Procesi i njoftimit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radioidentike të të njëjtit tip, pavarësisht autorit të njoftimit.

5.28 Në përfundim të procedurës së njoftimit, AKEP-i regjistron në bazën e të dhënave, tipin e pajisjes radio, parametrat përkatës dhe subjektin, i cili ka dërguar njoftimin.

5.29 Për pajisjet e radiokomunikimit me përdorim dhe qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, jo më shumë se tre muaj, AKEP-i në rastet e justifikuara mund të bëjë njohjen e konformitetit me procedurë të përshpejtuar.

6. Klasifikimi i pajisjeve radio

6.1 Aparatet janë të identifikuar në dy klasa:

Klasa 1 do t'i referohet pajisjeve, të cilat mund të vendosen në treg dhe të vendosen në shërbim pa kufizime. Për këtë klasë të pajisjeve, nuk është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Në këtë klasë janë të përfshira:

- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që përfshihen në rrjetet fikse;
- pajisjet radio jotransmetuese (vetëm pajisjet marrëse);
- pajisjet radio, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti;
- radiotransmetuesit, që punojnë në breza të frekuencave të harmonizuara në Shqipëri dhe në vendet e Bashkimit Europian.

Klasa 2 do t'i referohet pajisjeve për të cilat janë aplikuar kufizime gjatë vendosjes në treg ose vendosjes në shërbim. Për këtë klasë të pajisjeve është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Pajisja e kësaj klase duhet të shënohet me një simbol lajmëruar (një rreth me një pikëçuditëse brenda saj). Ky simbol tregon që pajisja radiotransmetuese punon në breza frekuence jo të harmonizuara. Pajisja radio, e cila nuk i përket klasës 1, siç janë ato të cilat përdorin breza frekuence jo të harmonizuara, përfshihet në klasën 2.

7. Vendosja në shërbim

7.1 Aparatet vihen në shërbim sipas qëllimit të parashikuar nga fabrikuesi vetëm kur ato plotësojnë kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse të këtij rregulli teknik.

7.2 AKEP-i mund të kufizojë vënien në shërbim të pajisjeve radio vetëm për shkaqe apo arsye në lidhje me përdorimin efektiv dhe të përshtatshëm të spektrit të radios, shmangien e interferencave të dëmshme ose në lidhje me çështje të shëndetit publik.

7.3 Përdoruesi i aparateve është përgjegjës për përdorimin korrekt të tyre.

7.4 Subjektet që punojnë në fushën e komunikimeve elektronike, nuk mund të refuzojnë një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje fundore të telekomunikacioneve me ndërfaqet e përshtatshme mbi baza teknike, e cila është në përputhje me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik.

7.5 Në qoftë se AKEP-i konkludon që një aparat i deklaruar në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, shkakton dëmtime serioze të rrjetit radio ose të telekomunikacioneve, interferenca të dëmshme ose interferenca në funksionimin e këtij rrjeti, autorizon operatorin të refuzojë lidhjen e këtij aparati në rrjetin e tij, ta heqë nga lidhja aparatit, ose ta heqë nga përdorimi. AKEP-i duhet të informojë pa vonesë ministrin përgjegjës për telekomunikacionin mbi masat e ndërmarra.

7.6 Në rast emergjence, një operator mund të heqë nga lidhja pajisjen, në qoftë se mbrojtja e rrjetit kërkon që pajisja të hiqet nga lidhja pa vonesë dhe, në qoftë se përdoruesit mund t'i ofrohet pa vonesë dhe pa kosto një zgjidhje tjetër alternative. Në këtë rast, operatori duhet të informojë menjëherë AKEP-in.

7.7 Aparati, i cili është importuar, vendosur në treg dhe në shërbim në Republikën e Shqipërisë, nuk duhet të krijojë fusha elektromagnetike mbi vlerat e parashikuara në rregulloret e pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve.

7.8 Vlerat limit të fushës elektromagnetike, vlerat limit të fuqisë së rrezatuar, si dhe kushte të tjera, të cilat duhet të plotësohen nga aparatet, si një burim i rrezatimit elektromagnetik të radiofrekuencave, duhet të jenë sipas vlerave të miratuara.

7.9 Përdoruesit e aparateve duhet t'u mundësojnë personave të autorizuar nga AKEP-i të kryejnë inspektime, matje dhe teste të nevojshme, me qëllim detektimin e burimeve të interferencës, të ofrojnë të dhëna dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e inspektimeve, matjeve dhe testeve.

7.10 Në qoftë se nga inspektimi evidentohet, që aparati shkakton interferencë mbi nivelin e lejuar, personat e autorizuar mund të kërkojnë nga përdoruesi i kësaj pajisje të eliminojë brenda një kohe të caktuar interferencën e evidentuar dhe të informojë AKEP-in për këtë.

7.11 Inspektimi i pajisjeve radio dhe mbikëqyrja e tregut për zbatimin e këtij rregulli bëhet nga AKEP-i.

7.12 Në qoftë se përdoruesi i aparateve, të cilat shkaktojnë interferencë, nuk eliminon interferencat e evidentuara në një kohë të përcaktuar, atëherë merren masat e parashikuara në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008.

8. Vlerësimi i konformitetit

8.1 Fabrikuesi është përgjegjës për konformitetin e produktit të tij me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në pikën 3 të këtij rregulli.

8.2 Procedurat e vlerësimit të konformitetit, të identifikuar në këtë pikë, duhet të përdoren për të demonstruar përputhjen e aparateve me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në pikën 3 të këtij rregulli.

8.3 Procedurat e vlerësimit të konformitetit, të identifikuar në këtë rregull teknik, duhet të kryhen nga fabrikuesit e aparateve.

8.4 Fabrikuesi i aparateve mund të zgjedhë një nga procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në tabelën 1 më poshtë dhe në pikat e mëposhtme sipas këtij rregulli.

8.5 Në fund të procedurës së vlerësimit të konformitetit, fabrikuesi harton një deklaratë të shkruar të konformitetit të pajisjes sipas kërkesave thelbësore.

8.6 Sipas zgjedhjes së fabrikuesit, përputhja e aparatit me kërkesat thelbësore referuar në nenin 3, të identifikuar në paragrafin 3.1(a) dhe 3.1(b) mund të demonstrohet, duke përdorur procedurat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.369, datë 27.3.2008 “Për miratimin e rregullimit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorimin brenda disa kufijve të tensionit”” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.864, datë 18.6.2008 “Për miratimin e rregullimit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike””, respektivisht, kur aparati është brenda fushës së veprimit të këtyre direktivave. Kjo mund të jetë si një alternativë ndaj procedurave që do të trajtohen më poshtë.

8.7 Pajisjet fundore të telekomunikacionit, të cilat nuk përdorin spektrin e përcaktuar për radiokomunikimin tokësor/hapësinor dhe pjesët marrëse në pajisjet radio, duhet të jenë subjekt i procedurave të përshkruara në cilindo prej anekseve 2, 4 ose 5, sipas zgjedhjes së fabrikuesit.

8.8 Kur një fabrikues ka aplikuar standardet e harmonizuara, pajisjet radio, që nuk janë të përfshira në fushën e veprimit të paragrafit 8.7, duhet të jenë subjekt i procedurave të përshkruara në cilindo prej anekseve 3, 4 ose 5, sipas zgjedhjes së fabrikuesit.

8.9 Kur një fabrikues nuk ka aplikuar ose i ka aplikuar vetëm pjesërisht standardet e harmonizuara, pajisjet radio që nuk janë të përfshira në fushën e veprimit të paragrafit 8.7 duhet të jenë subjekt i procedurave të përshkruara në njërin prej anekseve 4 ose 5, sipas zgjedhjes së fabrikuesit.

Tipi i pajisjes	Procedura e vlerësimit teknik			
	Aneksi II	Aneksi III	Aneksi IV	Aneksi V
Pajisja fundore e telekomunikacioneve	X		X	X
Pjesët marrëse të pajisjeve radio	X		X	X
Pajisja radio me aplikim të plotë të standardeve të harmonizuara		X	X	X
Pajisja radio me aplikim të pjesshëm ose jo të standardeve të harmonizuara			X	X

Tabela 1

9. Organet e autorizuar

Organet e autorizuar përcaktohen nga ministri përgjegjës në përputhje me nenin 14 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007. Në caktimin e organeve të autorizuar për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve, përveç sa përcaktohen në ligjin nr.9779, datë 16.7.2007, mbahen parasysh kriteret e përcaktuara në aneksin 7 të këtij rregull teknik.

10. Vendosja e markimit CE të pajisjeve

10.1 Aparatet që janë në përputhje me kërkesat thelbësore përkatëse mbajnë markimin CE, sipas kërkesave të kësaj pike. Markimi CE është një deklaram i fabrikuesit, që produkti është në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik dhe që procedurat e caktuara të vlerësimit të konformitetit janë kryer.

10.2 Përgjegjës për fiksimin e markimit CE është fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg.

10.3 Markimi CE mund të fiksohet në pajisje vetëm në qoftë se pajisja përputhet me të gjitha kërkesa thelbësore. Markimi CE duhet të shfaqet te pajisja, në paketim dhe në manualin e përdorimit.

10.4 Markimi CE duhet të fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të mos fshihet.

10.5 Në qoftë se fabrikuesi është konsultuar me një organ të autorizuar për vlerësimin e konformitetit, numri i identifikimit të organit të autorizuar (NBnr) duhet të shtohet te markimi CE.

10.6 Numri i identifikimit të organit të autorizuar përbëhet nga një sekuençë prej katër numrash. Organet e autorizuar, sipas pikës 9 më sipër dhe numri i tyre i identifikimit, janë të paraqitura në faqen zyrtare të AKEP-it dhe ministrisë përgjegjëse për telekomunikacionin.

10.7 Në qoftë se ka kufizime në përdorimin e pajisjes radio, kjo duhet treguar me anë të një simboli lajmërues së bashku me markimin CE dhe/ose numrin e identifikimit të organit të autorizuar, si në figurën 1.



Markimi CE

Numri i identifikimit
të organit të autorizuar
(NBnr)

Simboli
lajmërues

Figura 1

10.8 Aparati duhet të identifikohet nga fabrikuesi me anë të tipit, grupit dhe/ose numrit serial, si dhe me anë të emrit të fabrikuesit ose të personit që është përgjegjës për vendosjen e aparatit në treg.

10.9 Markimi CE dhe shenjat e tjera shtesë, duhet të jenë të paraqitura sipas rekomandimeve të këtij rregulli.

10.10 Pajisjet që përputhen me kërkesat thelbësore duhet të mbajnë shenjën e markimit CE, siç përcaktohet në aneksin 6. Në aneksin 6 është përcaktuar, gjithashtu, se kur është e nevojshme vendosja krahas markimit CE edhe e një elementi tjetër shtesë.

10.11 Vetëm kur përdoren procedurat e vlerësimit të konformitetit, të paraqitura në anekset 3, 4 dhe 5, markimi CE duhet të shoqërohet me numrin e identifikimit të organit të autorizuar.

10.12 Çdo shenjë tjetër nuk duhet të kufizojë shikimin dhe lexueshmerinë e markimit CE.

10.13 Vendosja në treg, lëvizja e lirë dhe përdorimi pa kufizime i pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, që mbajnë markim CE, bëhet sipas përcaktimeve të paragrafëve 5.6, 6.1 dhe aneksit 6.

10.14 Pajisjet radio që punojnë në breza të frekuencave, përdorimi i të cilave nuk është i harmonizuar, përveç markimit CE, vendoset edhe një shenjë lajmëruese, siç përcaktohet në aneksin 6.

11. Mbikëqyrja e tregut

11.1 Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës kryen funksionet mbikëqyrëse në bazë të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007.

11.2 AKEP-i është struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit.

11.3 Objektivat e mbikëqyrjes së tregut përfshijnë:

- të sigurojë që produktet në treg përputhen me kërkesat thelbësore të këtij rregulli teknik;
- të kontrollojë nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë rregull teknik;
- të kontrollojë që fiksimi dhe përdorimi i markimit CE është korrekt dhe, nëse principet lidhur me shenjat e tjera shtesë janë respektuar.

11.4 Deklaratat e konformitetit duhet të jenë të disponueshme sa herë që ato të kërkojnë nga autoritetet e inspektimit. Për më tepër, çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar deri te përdoruesi me deklaratën e konformitetit.

11.5 Në rast se pajisjet e vendosura në treg paraqiten jo në konformitet, me kushtet e përcaktuara në këtë rregull, atëherë AKEP-i merr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11.6 AKEP-i ka autoritetin të ndalojë, të kufizojë ose të heqë nga përdorimi pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacionit, që shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë interferenca të dëmshme.

11.7 Pronari i pajisjeve radio ose pajisjeve fundore të telekomunikacioneve nuk ka të drejtë të pengojë inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë dhe të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm sa herë që kërkohej një gjë e tillë.

11.8 Nëse gjatë inspektimit nevojitet ekspertizë e veçantë, atëherë mund të merren edhe ekspertë të tjerë në fusha të caktuara.

11.9 Kur gjatë inspektimit verifikohet që aparatet në përdorim nuk përputhen me këtë rregull teknik, AKEP-i duhet të marrë masat e nevojshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

11.10 Inspektorët e AKEP-it pajisen me dokument të posaçëm të identifikimit. Për të verifikuar zbatimin e këtij rregulli, ata kryejnë inspektim në mjediset ku subjekti zhvillon veprimtarinë. Ky inspektim mund të kryhet, gjithashtu, pa e njoftuar paraprakisht subjektin përkatës.

12. Pagesat

12.1 Pagesa për subjektet fabrikuese dhe tregtuese të pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, të cilat fitojnë njohjen e konformitetit, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike.

12.2 Pagesa për subjektet jotregtuese dhe subjektet përdoruese të pajisjeve radio ose pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, të cilat fitojnë njohjen e konformitetit, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike.

12.3 Kompanitë e huaja që aplikojnë për njohjen e konformitetit të pajisjeve radio, përveç pagesës për njohjen e konformitetit të tyre, duhet të paguajnë, gjithashtu, edhe shpenzimet postare.

13. Dispozita kalimtare

13.1 Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve, të cilat kanë kaluar në procedurën e miratimit të tipit bazuar në ligjin nr.8618, datë 14.6.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren e ERT “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve”, nuk është e nevojshme që subjektet e interesuara të njoftojnë në AKEP, kur pajisjet radio nuk kanë ndryshime në specifikimet teknike, apo nuk ka ndryshime në planin kombëtar të frekuencave, si dhe në përcaktimet e radiatorregulloreve të ITU-së dhe dokumentet përkatëse të CEPT/ERO.

13.2 Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij rregulli teknik, AKEP-i publikon listën e pajisjeve të parashikuara në pikën 5.6 për të cilat nuk duhet të kryhet procedura e njohjes së konformitetit.

ANEKSI 1

PAJISJET QË NUK MBULOHEN NGA KY RREGULL

1. Pajisja radio që përdoret nga radioamatorët (sipas përcaktimit në pikën 53 të nenit 1 të radorregulloreve të ITU-së), përveç se kur pajisja është e mundshme për t'u tregtuar.

Pjesët përbërëse të komponentëve të montuara nga radioamatorët dhe pajisje të tregtueshme, të modifikuara dhe të përdorura prej radioamatorëve, që nuk konsiderohen si pajisje të mundshme për t'u tregtuar.

2. Pajisjet e marinës.

3. Instalimet kabllore dhe me tel.

4. Pajisja radiomarrëse që ka për qëllim përdorimin vetëm për shërbimet e marrjes së transmetimeve audio dhe TV.

5. Pajisje të caktuara që përdoren në aviacionin civil.
6. Pajisje të caktuara për menaxhimin e trafikut ajror.

ANEKSI 2
PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT ME ANË TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË PRODHIMIT
(MODULI A)

Ky modul përshkruan procedurën me anë të së cilës fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron dhe deklaron që produktet plotësojnë kërkesat thelbësore.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, duhet të fiksojë markimin CE te çdo produkt dhe të hartojë një deklaratë të shkruar të konformitetit.

Fabrikuesi duhet të krijojë një dokumentacion teknik dhe ai ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet ta ruajnë për një periudhë që mbaron të paktën 10 vjet pas prodhimit të produktit të fundit për qëllime inspektimi.

Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të produktit me kërkesat thelbësore. Ai duhet të mbulojë projektimin, prodhimin dhe operimin e produktit.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet ta mbajë një kopje të deklaratës së konformitetit me dokumentacionin teknik.

Fabrikuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë përputhjen e produkteve të prodhuara me dokumentacionin teknik dhe me kushtet e këtij rregulli.

ANEKSI 3
PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT ME ANË TË KONTROLLIT TË
BRENDSHËM TË PRODHIMIT PLUS TESTET SPECIFIKE TË APARATIT (MODULI A-1)

Ky modul konsiston në aneksin 2, plus kërkesat plotësuese të mëposhtme:

Për çdo lloj aparati, të gjitha kompletet specifike të radiotestimit duhet të kryen nga fabrikuesi, ose në emër të tij. Identifikimi i kompletëve të testimit që janë konsideruar të jenë thelbësore është përgjegjësi e një organi të autorizuar/organizëm europian i notifikuar të zgjedhur nga fabrikuesi, me përjashtim kur kompletet e testimit janë përcaktuar në standardet e harmonizuara. Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të marrë parasysh vendimet e mëparshme të marra nga organet e akredituara duke vepruar së bashku. Në qoftë se kompletet specifike të radiotestimit janë zgjedhur nga një standard i harmonizuar, një organi të autorizuar/organizëm europian i notifikuar nuk duhet të ndërhyjë në procesin e vlerësimit të konformitetit.

Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg, duhet të deklarojë me një deklaratë të konformitetit që këto teste janë kryer dhe që pajisja përputhet me kërkesat thelbësore.

Në qoftë se një organ i akredituar ka ndërhyrë në këtë procedurë, fabrikuesi e ofron pajisjen me markimin CE së bashku me numrin e identifikimit të organit të autorizuar/organizëm europian të notifikuar.

ANEKSI 4
PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT ME ANË TË DOKUMENTACIONIT
TEKNIK

Ky aneks konsiston në aneksin 3, plus kërkesat plotësuese të mëposhtme:

Dokumentacioni teknik dhe deklarata e konformitetit për kompletet specifike të radiotestimit, të përshkruara në aneksin 3 duhet të formojnë një dosje të ndërtimit teknik.

Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg, duhet të paraqesë dokumentacionin teknik të ndërtimit teknik të një ose më shumë organe të autorizuar/organizëm europian i notifikuar dhe secili prej organeve duhet të jetë i informuar nga të tjerët, të cilët kanë marrë këtë dokumentacion teknik.

Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të rishikojë *file-in* e përgatitur nga fabrikuesi, në qoftë se konsiderohet që ai nuk ka demonstruar siç duhet që kërkesat thelbësore janë

plotësuar. Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar... duhet të lëshojë një opinion të konformitetit për fabrikuesin, përfaqësuesin e tij ose personin përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg dhe duhet të informojë organet e tjera të akredituara, të cilat e kanë marrë këtë *file*.

Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg, duhet ta ruajë dokumentacionin teknik për një periudhë, e cila mbaron të paktën 10 vjet pas prodhimit të produktit të fundit për qëllime inspektimi.

ANEKSI 5 PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT ME ANË TË SIGURIMIT TË PLOTË TË CILËSISË

Në këtë procedurë, fabrikuesi duhet të operojë një sistem cilësie të aprovuar për projektimin, prodhimin, inspektimin e produktit final dhe fazat e testimit. Fabrikuesi duhet të prezantojë një aplikim për vlerësimin e sistemit të tij të cilësisë te një organ i autorizuar/organizëm europian i notifikuar. Aplikimi duhet të përfshijë informacionin teknik për produktin dhe dokumentacionin e sistemit të cilësisë.

Sistemi i cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e produktit me kërkesat e këtyre rregullave. Të gjitha elementet, kërkesat dhe kushtet e adaptuara prej fabrikuesit, duhet të jenë të dokumentuara në një mënyrë sistematike e të rregullt në formën e politikave, procedurave dhe instruksioneve të shkruara.

Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të vlerësojë në veçanti nëse sistemi i kontrollit të cilësisë e siguron konformitetin e produktit me kërkesat thelbësore në dritën e dokumentacionit të përshtatshëm të ofruar nga fabrikuesi.

Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të njoftojë vendimin e tij te fabrikuesi. Njoftimi duhet të përmbajë konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e arsyetuar të vlerësimit.

Në procedurën e sigurimit të plotë të cilësisë duhet të jetë e përfshirë, gjithashtu, mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të akredituar.

Qëllimi i mbikëqyrjes është të sigurojë që fabrikuesi ka plotësuar siç duhet detyrimet e ngritura për sistemin e aprovuar të cilësisë. Fabrikuesi duhet të lejojë organin e akredituar të hyjë për qëllime inspektimi në vendet e projektimit, prodhimit, inspektimit e testimit, të magazinimit dhe duhet t'i ofrojë atij të gjithë informacionin e nevojshëm.







Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të kryejë auditime në intervale kohe të arsyeshme, me qëllim që të certifikojë sistemin e cilësisë dhe që të garantojë se fabrikuesi e mban dhe e aplikon sistemin e cilësisë. Organi i autorizuar/organizëm europian i notifikuar duhet të ofrojë një raport auditimi te fabrikuesi.

Fabrikuesi duhet për një periudhë, e cila mbaron të paktën 10 vjet pas prodhimit të produktit të fundit, ta ruajë këtë dokumentacion për qëllime inspektimi.

Çdo organ i akredituar/organizëm europian i notifikuar duhet ta bëjë të disponueshëm për organet e tjera të akredituara informacionin përkatës që lidhet me aprovimet e sistemit të cilësisë.

ANEKSI 6 SHËNIMI I PAJISJEVE RADIO DHE PAJISJEVE FUNDORË TË TELEKOMUNIKACIONEVE SIPAS PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

Pajisjet fundore të telekomunikacioneve (joradio)	
Procedura e konformitetit	Shënimi
Aneksi II (Kontrolli i prodhimit të brendshëm)	CE
Aneksi IV (<i>File</i> i ndërtimit teknik) ose Aneksi V (Siguria e plotë e cilësisë)	CE NBnr

Pajisjet radio		
Procedura e konformitetit	Brezi i frekuencave	
	I harmonizuar	Jo i harmonizuar
Aneksi III – Kontrolli i prodhimit të brendshëm dhe testet specifike të pajisjes (përdorimi i standardeve të harmonizuara)	 	 
Aneksi IV – File i ndërtimit teknik ose Aneksi V – Siguria e plotë e cilësisë		

ANEKSI 7

KRITERET MINIMALE QË DUHET TË MERREN PARASYSH NGA SHTETET ANËTARE KUR EMËROJNË ORGANET E AKREDITUARA NË PAJTIM ME ARTIKULLIN 11(1)

1. Organi i autorizuar, drejtuesit e tij dhe stafi përgjegjës për kryerjen e detyrave, për të cilat organi i autorizuar është emëruar, nuk duhet të jetë një projektues, prodhues, furnitor ose instalues i pajisjeve radio, ose të pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, ose një operator rrjeti, ose një furnizues shërbimesh, as përfaqësues i autorizuar i ndonjë prej këtyre palëve. Ata duhet të jenë të pavarur dhe të mos përfshihen direkt në projektimin, konstruktimin, tregtimin ose mirëmbajtjen e pajisjeve radio ose të pajisjeve fundore të telekomunikacioneve, dhe as të përfaqësojnë palët e përfshira në këto aktivitete. Kjo nuk përjashton mundësinë e shkëmbimeve të informacionit teknik ndërmjet prodhuesit dhe organit të autorizuar.

2. Organi i autorizuar dhe stafi i tij duhet të kryejnë detyrat, për të cilat organi i autorizuar është emëruar, me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe të kompetencës teknike dhe duhet të jetë i lirë nga të gjitha presionet dhe influencat, në veçanti ato financiare, të cilat mund ta influencojnë gjykimin e tyre ose në rezultatet e inspektimeve, veçanërisht nga persona ose grupe personash që kanë interes në këto rezultate.

3. Organi i autorizuar duhet të ketë në dispozicionin e tij stafin dhe lehtësitë e nevojshme për t'i mundësuar atij të kryejë siç duhet punën administrative dhe teknike lidhur me detyrat për të cilat ai është caktuar.

4. Stafi përgjegjës për inspektimet duhet të ketë:

- një trajnim të mirë teknik dhe profesional;
- njohuri të kënaqshme mbi kërkesat e testeve ose inspektimeve që kryhen dhe eksperiencë të përshtatshme për këto teste ose inspektime;
- aftësi për të formuluar certifikatat, regjistrimet dhe raportet e nevojshme për të vërtetuar kryerjen e inspektimeve.

5. Objektiviteti i stafit të inspektimit duhet të jetë i garantuar. Shpërblimi i tyre nuk duhet të varet nga numri i testeve ose inspektimeve të kryera dhe as nga rezultatet e këtyre inspektimeve.

6. Stafi i organit të autorizuar është i detyruar të zbatojë sekretin profesional ndaj të gjitha informacioneve të fituara gjatë kryerjes së detyrave të tij.

ANEKSI 8
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Rruga: “Reshit Çollaku” nr.43, Tiranë, Shqipëri
Fax: +355 4259106
Web site: www.akep.al
E-mail: info@akep.al

**FORMULAR PËR NJOFTIMIN E PAJISJEVE RADIO
MBI IMPORTIMIN DHE/OSE VENDOSJEN NË TREG TË PAJISJEVE RADIO**

Pajisja radio duhet të jetë në pajtim me kërkesat thelbësore të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. ____, datë ____ “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”. AKEP-i ka përgjegjësinë për të konfirmuar njohjen e konformitetit. Ky proces duhet të fillojë përpara importimit, vendosjes në treg ose futjes në shërbim të pajisjes radio.

Subjekti _____, përfaqësuar nga z/znj _____ që zhvillon aktivitet në fushën e:

prodhimit importimit vendosjes në treg futjes në përdorim

të pajisjeve radio, njofton “Organin e autorizuar” për të fituar njohjen e konformitetit për pajisjen me të dhënat e mëposhtme:

1. Subjekti përgjegjës për të fituar njohjen e konformitetit të pajisjes radio

Subjekt përgjegjës do të quajmë fabrikuesin, përfaqësuesin e tij të autorizuar dhe çdo person tjetër, i cili importon dhe/ose vendos në treg pajisje radio.

Subjekti/emri:	
Personi i kontaktit:	
Adresa:	
Telefon:	
Fax:	
E-mail:	

2. Fabrikuesi i pajisjes

Kompania/emri:	
Adresa:	
Telefon:	
Fax:	
E-mail:	

3. Informacion mbi pajisjen radio të njoftuar

Kategoria e pajisjes	
Tipi i pajisjes	
Marka e regjistruar	

4. Qëllimi i përdorimit të pajisjes

Këtu duhet të jetë një përshkrim i shkurtër i qëllimit të përdorimit të pajisjes, siç është përcaktuar nga fabrikuesi.

--

5. Specifikimet teknike kryesore të pajisjes

	Informacion	Përgjigje
	Brezi i frekuencave	
	Frekuenca e punës/frekuencat	
	Lloji i modulimit	
	Numri i kanaleve	
	Hapësira e kanalit	
	Klasa e emisionit	
	Fuqia max në dalje ose fuqia e rrezatuar	
	Duty cycle	
	Channel access protocol	
	Mënyra e operimit (simplex/duplex)	
	Maximal data rate	
	Tipi i antenës	
	Tensioni i ushqimit	
	Informacion shtesë	

6. Informacion mbi vlerësimin e konformitetit me kërkesat thelbësore

	Informacion	Përgjigje
	Procedura e aplikuar e vlerësimit të konformitetit (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”)	<input type="checkbox"/> Aneksi II <input type="checkbox"/> Aneksi IV <input type="checkbox"/> Aneksi III <input type="checkbox"/> Aneksi V
	Standardet e harmonizuara	
	Numri i identifikimit të organit të autorizuar: (Numri ose numrat e organeve të autorizuar që janë të përfshira në procedurën e vlerësimit të konformitetit)	

7. Deklaratat e konformitetit që janë bashkëngjitur me njoftimin

Fabrikuesi dhe/ose organi i autorizuar kanë përgjegjësinë e plotë për të siguruar që pajisja është në konformitet me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. ____, datë ____ “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”.

Deklarata e fabrikuesit për konformitetin

Opinionin e organit të autorizuar për konformitetin

Deklarim

Jemi të vetëdijshëm që ky njoftim nuk na siguron mundësinë e futjes në shërbim në Republikën e Shqipërisë të pajisjes së njoftuar. Përdorimi i kësaj pajisjeje mund të jetë i kufizuar sipas dispozitave të tjera.

Asnjë pretendim zyrtar për caktimin e një frekuence nuk mund të vijë si rrjedhim i këtij njoftimi.

Nëpërmjet kësaj deklarate ju vëmë në dijeni që unë jam caktuar të nënshkruaj këtë njoftim dhe që informacioni i paraqitur këtu është korrekt dhe i plotë.

Vendi dhe data e njoftimit: _____

Emri dhe mbiemri: _____

Nënshkrimi dhe vula e subjektit përgjegjës ose e subjektit të autorizuar: _____

Në rast se njoftimi paraqitet nga një subjekt i autorizuar, atëherë është e nevojshme të paraqitet një autorizim nga ana e tij.

8. Informacioni shtesë mbi përdorimin e pajisjes radio të njoftuar

	Vendi	Përdorimi aktual	Përdorimi i planifikuar	Vërejtje
	Austria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Belgjika	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Bullgaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Qipro	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Republika Çeke	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Danimarka	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Estonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Finlanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Franca	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Gjermania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Greqia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Hungaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Islanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Irlanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Italia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Letonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Lituania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Luksemburgu	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Malta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Holanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Norvegjia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Polonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Portugalia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Rumania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Slovakia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Sllovenia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Spanja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Suedia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Zvicra	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Mbretëria e Bashkuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

Këtu duhet të jenë të specifikuara vendet ku pajisja radio është përdorur ose është planifikuar për t'u përdorur në të ardhmen.

Bashkëngjitur me njoftimin duhet të jenë:

1. Përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike sipas dokumentacionit të fabrikuesit ose raportet e testimit.
- 2./2.-3. Deklarata e konformitetit lëshuar nga fabrikuesi sipas vendimit të Këshillit të Ministrave “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve” dhe/ose opinionin e organit të autorizuar, nëse ky është parashikuar, të përfshihet në procedurën e vlerësimit të konformitetit.

ANEKSI 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KONFIRMIM PËR NJOHJEN E KONFORMITETIT
PËR PAJISJEN RADIO

Nr. _____ dt. _____

Mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr., datë,2011 "Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve të radiove dhe fundore të telekomunikacionit"" dhe bazuar në njoftimin e datës _____ prezantuar nga subjekti _____ (*Adresa: . . .*), është kërkuar njohja e konformitetit të pajisjes radio të mëposhtme:

• **Kategoria e pajisjes:**

• **Tipi i pajisjes:**

• **Fabrikuesi:**

• **Marka e regjistruar:**

• **Funksioni i ofruar (përshkrim i shkurtër):**

• **Karakteristikat kryesore teknike:**

• **Deklarata e fabrikuesit dhe/ose opinionit të akredituar për konformitet me kërkesat thelbësore:**

AKEP

konfirmon njohjen e konformitetit dhe i jep subjektit

të drejtën për të importuar dhe/ose vendosur tipin e mësipërm të pajisjes radio në tregun e Republikës së Shqipërisë.

Markimi CE dhe shenjat e tjera shtesë duhet të jenë të paraqitura në pajisjen radio sipas këtij rregulli teknik.

(Emri, mbiemri)

VENDIM
Nr.391, datë 1.6.2011

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË “NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.10 376, datë 10.2.2011 “Për krijimin e shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STATUTI I SHOQËRISË
“NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SHA

TITULLI I
EMËRTIMI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI

Neni 1
Emërtimi

1. Shoqëria emërtohet “Nxitja e biznesit social” sh.a. (këtej e tutje referuar si “Shoqëria”).
2. Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2
Selia

1. Selia e shoqërisë është në Tiranë, Shqipëri.
2. Këshilli i administrimit mund të hapë dhe/ose të mbyllë shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci ose zyra përfaqësimi në Shqipëri dhe/ose jashtë saj.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 4
Objekti

1. Objekti i shoqërisë është zhvillimi ekonomik dhe social i qëndrueshëm, përmes nxitjes për zhvillim në nivel kombëtar të një biznesi social të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv.
2. Për arritjen e qëllimit të sipërpërmendur, shoqëria ndjek qëllimet e saj sociale dhe mjedisore, përmes mbështetjes dhe nxitjes së bizneseve sociale dhe të mikrofinancës, si dhe krijon mundësi për të ardhura të qëndrueshme për shtresat e varfra të shoqërisë në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund t’ua delegojë disa prej veprimtarive të saj palëve të treta, në mënyrë që t’i arrijë këto qëllime sociale dhe mjedisore.

3. Një biznes social është biznesi që ka për qëllim zgjidhjen e problemeve sociale dhe mjedisore, në të cilin fitimet nuk paguhen në formën e dividendëve dhe që respekton parimet në vijim:

- a) qëllimi i biznesit nuk është maksimizimi i fitimeve, por përqendrimi në zgjidhjen e problemeve sociale ose mjedisore;
- b) biznesi social karakterizohet nga qëndrueshmëria ekonomiko-financiare;
- c) investitorët nuk përfitojnë dividend përtej shumës së derdhur në shoqëri;
- ç) fitimi i krijuar nga biznesi social riinvestohet brenda biznesit, për të zgjeruar dhe përmirësuar impaktin e tij, ose përdoret për veprimtari të tjera biznesi social;
- d) biznesi social është i ndërgjegjshëm për impaktin e tij në mjedis.

TITULLI II KAPITALI, AKSIONET DHE TRANSFERIMI I AKSIONEVE

Neni 5 **Kapitali**

1. Kapitali i nënshkruar dhe i paguar i shoqërisë është ALL 2 000 000 (dy milionë) lekë, i përbërë nga 10 000 (dhjetë mijë) aksione të zakonshme, me vlerë nominale prej ALL 200 (dyqind) lekësh shqiptarë secili.

2. Në çastin e themelimit, kapitali është nënshkruar dhe është shlyer tërësisht, si më poshtë vijon:

- shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, ka kontribuar në para në kapitalin e shoqërisë, me një shumë të barabartë prej ALL 2 000 000 (dy milionë) lekësh shqiptarë.

3. Në çastin e themelimit, bazuar në kontributet e sipërpërmendura:

- shteti shqiptar, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, zotëron 10 000 (dhjetë mijë) aksione të barabarta me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të shoqërisë (këtej e tutje referuar si “Aksionari i vetëm”).

Neni 6 **Aksionet dhe regjistri i aksioneve**

1. Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme.

2. Çdo aksion jep të drejtën e një vote.

3. Një akt emetimi aksionesh hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban informacionet e kërkuara nga ligji.

4. Shoqëria harton dhe mban një regjistër të aksionarëve në selinë e shoqërisë, ku përcaktohen:

- emri dhe mbiemri ose emërtimi i shoqërisë;

- numri i aksioneve;

- vlera nominale e aksioneve;

- adresa ose selia e aksionarëve;

- regjistrimi i datës së kryerjes së transaksionit.

5. Aksionarët e regjistruar në regjistrin e aksionarëve prezumohen aksionarë të shoqërisë me të drejta të plota, si në marrëdhëniet me shoqërinë, ashtu edhe ndaj të tretëve.

Neni 7 **Transferimi i aksioneve**

Transferimi i aksioneve të të tretët i nënshtrohet miratimit të aksionarit të vetëm dhe kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për privatizimet.

Neni 8 **Rritja e kapitalit**

1. Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë pa limit, në çdo çast, një ose disa herë, kapitalin e shoqërisë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

2. Kontributet e reja për rritjen e kapitalit të shoqërisë mund të konsistojnë në para ose pasuri dhe të drejta të vlerësueshme në para. Kontributet nuk mund të jenë në punë apo shërbime.

Neni 9
Zvogëlimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e shoqërisë në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II
ORGANET E SHOQËRISË, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 10
Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i administrimit;
- c) Administratori.

Neni 11
Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

1. Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
2. Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme në një shoqëri me një aksionar ushtrohen nga aksionari i vetëm.
3. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonshme për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - c) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proceset gjyqësore ndaj anëtarëve të këshillit të administrimit dhe/ose administratorit;
 - ç) rregullat që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në Asamblenë e Përgjithshme;
 - d) çdo çështje tjetër, të përcaktuar nga ligji apo statuti.
4. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të jashtëzakonshme për çështjet e mëposhtme:
 - a) ndryshimin apo plotësimin e statutit të shoqërisë;
 - b) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - c) riinvestimin e fitimeve vjetore;
 - ç) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - d) ndryshimet në të drejtat që lidhen me aksionet e kategorive të ndryshme;
 - dh) riorganizimin, shpërndarjen, transformimin, bashkimin, shkrirjen, ndarjen, prishjen apo likuidimin e shoqërisë, si edhe riorganizimin e shoqërisë në një formë tjetër;
 - e) ndërmarrjen e çdo veprimi i cili pritet në mënyrë të arsyeshme se do të çojë në likuidimin e shoqërisë.
5. Nëse mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme nuk mbahet si rrjedhojë e mungesës së aksionarit të vetëm, asambleja mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, pas thirrjes së parë.

Neni 12
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, rendi i ditës dhe pjesëmarrja në Asamblenë e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo këshilli i administrimit.
2. Asambleja e Përgjithshme thirret sa herë që të jetë e nevojshme, për interesat e shoqërisë ose, në rast se kërkohet, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda muajit qershor të çdo viti, me qëllim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor të vitit ushtrimor të mëparshëm.

3. Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo është e qartë një humbje prej 50% (pesëdhjetë për qind) të kapitalit apo nëse ekziston rreziku se shoqëria gjatë veprimtarisë së saj nuk do të jetë në gjendje të mbulojë detyrimet e saj brenda 3 (tre) muajve të ardhshëm.

4. Njoftimi për thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me letër rekomande, me njoftim marrjeje apo postë elektronike, me marrje përgjigjeje të dërguar në adresën e aksionarit të vetëm, të regjistruar në regjistrin e aksionarëve, ose në adresën elektronike të aksionarit, të paktën 21 (njëzet e një) ditë, përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë.

5. Në njoftim jepen:

a) emërtimi dhe selia e shoqërisë dhe lloji i Asamblesë së Përgjithshme;
b) rendi i ditës, vendi, koha dhe data e thirrjes së parë dhe të dytë të Asamblesë së Përgjithshme;
c) një përshkrim i qartë dhe i saktë për procedurat, të cilat duhet të ndiqen nga aksionarët, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin pjesë dhe të votojnë në Asamblenë e Përgjithshme.

6. Rendi i ditës përmban vendimet e propozuara për çdo çështje, për të cilën Asambleja e Përgjithshme merr një vendim. Nëse Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë vendime, që kanë të bëjnë me projektpropozimet për ndryshime në statut, i përfshin si çështje të rendit të ditës këto projektpropozime.

7. Asambleja e Përgjithshme nuk diskuton çështje, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës. Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme nuk ndryshohet në njoftimin e dytë.

8. Asambleja e Përgjithshme mbahet pa respektuar formalitetet e sipërpërmendura nëse është i pranishëm aksionari i vetëm dhe nëse aksionari i vetëm nuk e kundërshton mbajtjen e saj.

9. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mbahet në një vendndodhje, të ndryshme nga selia e shoqërisë, brenda Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

10. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e personave të pranishëm në vende të ndryshme, të lidhur nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, në përputhje me metodat e zakonshme të telekomunikimit, ku përfshihen mjetet elektronike, me kusht që të gjithë aksionarët, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo mjeteve të ngjashme elektronike, të identifikohen dhe atyre t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet, për të marrë pjesë drejtpërdrejt në çështjet e trajtuara dhe për të marrë, dërguar ose shqyrtuar dokumentet.

11. Aksionari i vetëm ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, jo domosdoshmërisht aksionar, në bazë të një prokure me shkrim. Në çdo rast, prokura jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë të Përgjithshme dhe është e vlefshme për thirrjen e saj të parë dhe të dytë.

12. Aksionari nuk mund të lëshojë një prokurë për një pjesë të aksioneve që ai zotëron dhe të votojë personalisht për pjesën tjetër të këtyre aksioneve.

13. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme mund të marrin pjesë edhe anëtarët e këshillit të administrimit dhe administratori.

Neni 13

Drejtimi i Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga kryetari i këshillit të administrimit apo, në mungesë të tij, nga nënkryetari ose, në mungesë të tij, nga aksionari i vetëm a nga një person tjetër, i emëruar për këtë qëllim nga Asambleja e Përgjithshme. Nëse nuk kërkohet prania e një noteri publik, Asambleja e Përgjithshme duhet të emërojë një sekretar, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht aksionar.

2. Kryetari duhet të verifikojë vlefshmërinë e pjesëmarrjes së personave të pranishëm dhe rregullsinë e thirrjeve e të mbledhjes së asamblesë. Kryetari vendos për rendin e diskutimit dhe procedurat e votimit.

Neni 14

Procesverbalet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme regjistrohet në procesverbal. Administratori është përgjegjës për ruajtjen e procesverbaleve.

2. Në procesverbal shënohen të dhënat në vijim:

- vendi dhe data e mbledhjes;

- rendi i ditës, emri i kryetarit dhe emri i personit që mban procesverbalin;
- rezultatet e votimit;
- vendimet e marra dhe qëndrimi i kryetarit në lidhje me vendimmarrjen.

3. Procesverbalit i bashkëngjiten lista e pjesëmarrësve, si dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

4. Procesverbalit dhe lista e pjesëmarrësve nënshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 15

Këshilli i administrimit

1. Shoqëria drejtohet dhe mbikëqyret nga një këshill i administrimit, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.

2. Këshilli i administrimit drejtohet nga Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe përbëhet nga këta anëtarë:

- Zëvendësministri që mbulon çështjet e financave;
- Zëvendësministri që mbulon problemet e punës, të çështjeve sociale dhe të shanseve të barabarta;

- Zëvendësministri që mbulon çështjet e bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit;

- Drejtori ekzekutiv i Agjencisë për Zhvillimin e Zonave Malore;

- Këshilltari i Kryeministrit për çështjet ekonomike.

3. Titullarët e institucioneve, të përmendur në pikën 2 të këtij neni, depozitojnë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, emrat e përfaqësuesve të tyre në këtë këshill.

Neni 16

Kohëzgjatja në detyrë e anëtarëve të këshillit të administrimit

Anëtarët e këshillit të administrimit emërohen në detyrë, për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 17

Largimi i anëtarëve të këshillit të administrimit

Detyra e anëtarit të këshillit të administrimit përfundon kur personi:

a) pushon së qeni anëtar i këshillit të administrimit, në bazë të neneve 157 e 167 pika 4 të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;

b) përfundon së ushtruar funksionin sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij statusi;

c) vuan apo mund të vuajë nga çrregullime mendore;

d) jep dorëheqjen nga detyra, duke njoftuar shoqërinë;

ç) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi, pa lejen e anëtarëve të tjerë të këshillit të administrimit, në mbledhjet e këtij këshilli, të mbajtura gjatë kësaj periudhe, dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të këshillit drejtues, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 18

Kompetencat e këshillit të administrimit

1. Këshilli i administrimit, në cilësinë e organit mbikëqyrës, vëzhgon zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe është përgjegjës për të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

a) të udhëzojë administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

c) të përgatitë, me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t’i rekomandojë asaj vendimet e nevojshme për t’u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e Asamblesë;

ç) të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

- d) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- e) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratori. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit dhe t'i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- ë) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur, e raporti i auditimit, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të administrimit. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- f) të përcaktojë shpërblimin e administratorit;
- g) të vendosë për marrëdhëniet tregtare afatgjata nëpërmjet nënshkrimit të aktmarrëveshjeve përkatëse dhe të propozojë politika për themelimin e shoqërive ose të grupeve të reja;
- gj) të vendosë për krijimin, mbylljen apo transferimin e shoqërive të kontrolluara, të filialeve, degëve të shoqërisë, agjencive apo zyrave të përfaqësimit të saj;
- h) të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 19

Mbledhjet e këshillit të administrimit

1. Të gjitha mbledhjet e këshillit të administrimit mbahen në selinë e shoqërisë apo në një vend tjetër, sipas kërkesës së kryetarit të këshillit drejtues apo të shumicës së anëtarëve të këtij këshilli.
2. Këshilli i administrimit mbledhet jo më pak se 3 (tri) herë në vit, me intervale jo më të gjata se 4 (katër) muaj dhe në mënyrë të jashtëzakonshme, sa herë që vlerësohet si e nevojshme nga kryetari i këshillit të administrimit ose kurdo, që kërkohet nga një e treta e këtij këshilli.
3. Njoftimi i thirrjes, i nënshkruar nga pala apo palët thirrëse, në të cilin përcaktohen ora, dita, vendi, si dhe rendi i ditës, duhet t'u dërgohet të gjithë anëtarëve të këshillit të administrimit me letër, telegram, teleks, telefaks, e-mail apo me anë të çdo mjeti tjetër elektronik, i cili garanton marrjen e tij, të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen. Ky afat mund të zvogëlohet në 48 (dyzet e tetë) orë, në raste urgjence. Mbledhja e këshillit të administrimit quhet e thirrur rregullisht edhe pa përmbushur këto formalitete, nëse të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit ose përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje.
4. Pala apo palët thirrëse vënë, gjithashtu, në dispozicion të çdo anëtari të këshillit të administrimit të gjithë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, për çështjet që trajtohen, të paktën 7 (shtatë) ditë, para datës së caktuar për mbledhjen dhe, në rast urgjence, 48 (dyzet e tetë) orë përpara.
5. Këshilli i administrimit quhet i mbledhur rregullisht, nëse është e pranishme më shumë se një e dyta e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash. Në rast barazie votash, vota e kryetarit të këshillit të administrimit është vendimtare. Procesverbali i këshillit të administrimit nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.
6. Çdo mbledhje e këshillit të administrimit kryesohet nga kryetari i tij apo, në rast pamundësie ose në mungesë të tij, nga njëri prej anëtarëve të këshillit të administrimit, me moshën më të vjetër ndër të tjerët. Këshilli i administrimit emëron një sekretar të mbledhjes, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht anëtar.
7. Mbledhjet e këshillit të administrimit mund të zhvillohen, gjithashtu, nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës apo me mjete të ngjashme elektronike, me kusht që anëtarët e tjerë, të cilët marrin pjesë nëpërmjet telekonferencës apo videokonferencës ose nëpërmjet mjeteve të tjera të ngjashme, të identifikohen dhe të kenë mundësi të ndjekin diskutimet, të marrin pjesë në kohë reale në çështjet e diskutuara dhe të marrin, të transmetojnë dhe të shqyrtojnë dokumentet. Në këtë rast, mbledhja e këshillit të administrimit konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhen kryetari dhe sekretari i mbledhjes.
8. Kryetari mund të ftojë administratorin e shoqërisë për të marrë pjesë, për të paraqitur dhe/ose për të diskutuar për çështje, të lidhura me rendin e ditës së mbledhjes së këshillit të administrimit.

Neni 20
Administratori

1. Administratori i shoqërisë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga detyra me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Vendimet e përditshme, të cilat kanë të bëjnë me administrimin e shoqërisë, merren nga administratori.
3. Administratori i raporton këshillit të administrimit rregullisht dhe sa herë që ky këshill e kërkon.

Neni 21
Kompetencat e administratorit

1. Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, brenda kufijve të vendosur nga ligji, dhe kompetencat e deleguara shprehimisht nga këshilli i administrimit.
2. Administratori i shoqërisë merr pjesë në të gjitha mbledhjet e aksionarëve dhe të këshillit të administrimit, kryen të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe kujdeset për zbatimin e urdhrave e të vendimeve të këshillit të administrimit.
3. Administratori ka kompetencë të përfaqësojë shoqërinë, të nënshkruajë dokumentet dhe aktet për veprimtarinë e shoqërisë dhe të nënshkruajë çdo dokument, që duhet vulosur me vulën e shoqërisë, përveç rasteve në të cilat kërkohet apo lejohet nga ligji që dokumentet të nënshkruhen dhe të ekzekutohen në tjetër mënyrë, dhe përveç rastit kur nënshkrimi dhe ekzekutimi i sipërpërmendur i delegohen, shprehimisht, një punonjësi apo përfaqësuesi tjetër të shoqërisë nga këshilli i administrimit.
4. Administratori kryen edhe detyra të tjera, të parashikuara nga ligji, si dhe ato, të cilat i caktohen, kohë pas kohe, nga këshilli i administrimit.

Neni 22
Kontabiliteti

Shoqëria mban llogari të sakta dhe përgatit pasqyrat financiare, në të cilat paraqitet, në mënyrë të hollësishme, gjendja e saj financiare, në përputhje me parimet e konsoliduara të kontabilitetit. Forma e llogarive dhe e pasqyrave financiare dhe mënyra e paraqitjes me hollësi të tyre janë në përputhje me ato standarde kontabiliteti, sipas legjislationit në fuqi.

Neni 23
Eksperti kontabël i autorizuar

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë ekspertë kontabël të jashtëm e të pavarur, të cilët janë ekspertë kontabël të autorizuar sipas ligjit.
2. Ekspertët kontabël të autorizuar kanë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë, në përputhje me legjislationin në fuqi.

Neni 24
Viti financiar, pasqyrat financiare vjetore dhe ndarja e dividendëve

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.
2. Fitimet, që rezultojnë nga pasqyrat financiare vjetore, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme, shpërndahen, si më poshtë vijon:
 - a) 5% (pesë për qind) në vit caktohet si rezervë ligjore, deri në një maksimum prej 10% (dhjetë për qind) të kapitalit;
 - b) pjesa e mbetur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme riinvestohet në shoqëri ose në fonde të tjera rezervë.
3. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që fitimet të riinvestohen ose të destinohen në një fond special rezervë apo të vendosë një rritje kapitali.

Neni 25

Prishja, ndarja dhe bashkimi

1. Shoqëria mund të priset, si rrjedhojë e vërtetimit të shkaqeve, të parashikuara nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
2. Shoqëria mund të ndahet apo të bashkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 26

Likuidimi

1. Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
2. Në përputhje me këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët hartojnë raportin përfundimtar për aktivet dhe detyrimet e shoqërisë dhe për procedurat e kohën e duhur për likuidimin.
3. Në përfundim të procedurave të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos për bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesit dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
4. Pas shlyerjes së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të mbetura, likuiduesit u shpërndajnë aktivet e mbetura aksionarëve.

Neni 27

Dispozita përfundimtare

Çështjet, që nuk parashikohen shprehimisht nga ky statut, rregullohen nga ligji nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr.3880/3, datë 3.6.2011

**PËR PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT TË PËRMBARIMIT GJYQËSOR
SHTETËROR ME POLICINË E SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 523 të Kodit të Procedurës Civile, të nenit 30 të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarrimit gjyqësor”,

UDHËZOJMË:

1. Policia e Shtetit bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit dhe zyrat vendore të përmbarrimit gjyqësor shtetëror për të siguruar rendin dhe qetësinë publike para, gjatë dhe pas ekzekutimit të titujve ekzekutivë, me qëllim zbatimin e legjislacionit në fuqi, duke respektuar pavarësinë e tyre dhe shmangien e konflikteve civile që mund të gjenerojnë vepra penale.
2. Kërkesat për bashkëpunim kufizohen vetëm në ato raste kur strukturat e përmbarrimit gjyqësor shtetëror çmojnë që gjatë kryerjes së procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë do të ketë pengesa apo rezistencë për kryerjen e detyrës apo kur ka arsye të besueshme prej të cilave rrezikohet jeta e personave të pranishëm dhe ndërhyrja policore është e domosdoshme.
3. Me qëllim sigurimin e bashkëpunimit, zyrat vendore të përmbarrimit gjyqësor shtetëror i drejtohen Policisë së Shtetit në rrugë zyrtare jo më vonë se 3 ditë përpara ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Në rastet e urgjencës apo të ekzekutimit të titullit në mënyrë të menjëhershme, njoftimi bëhet verbalisht, por në këtë rast kërkesa me shkrim paraqitet jo më vonë se 24 orë përpara ekzekutimit të titullit ekzekutiv.
4. Në kërkesën për bashkëpunim, zyrat vendore të përmbarrimit gjyqësor shtetëror paraqesin çdo informacion të nevojshëm lidhur me situatat e krijuara në përputhje me pikën 2 të këtij udhëzimi, me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe mundësimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Policia e Shtetit detyrohet t'i përgjigjet kërkesës së bërë brenda 2 ditëve nga marrja e saj, me përjashtim të rasteve, të cilat çmohet se paraqesin urgjencë të veçantë apo legjislacioni në fuqi e parashikon ndryshe.

6. Me qëllim dhënien e ndihmës së kërkuar, Policia e Shtetit në varësi të situatës përcakton e vlerëson shkallën e rrezikshmërisë që mund të paraqitet gjatë procesit të ekzekutimit dhe mbi këtë bazë planifikon personelin, mjetet, pajisjet dhe mbështetjen teknike të nevojshme.

7. Në rast se për shkak të përmbushjes së detyrave të saj funksionale, për arsye madhore apo shkaqe të tjera të rëndësishme të veçantë, Policia e Shtetit nuk mund të mbështesë zyrat vendore të përmbartimit gjyqësor shtetëror, strukturat e Policisë së Shtetit njoftojnë me shkrim ose me mjet tjetër komunikimi këto struktura për mosmbështetjen me forca e mjete në datën e kërkuar, të paktën mbi 12 orë përpara datës dhe orës së caktuar për ekzekutim, duke argumentuar arsyen e mosbashkëpunimit apo të mosveprimit.

8. Gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë Policia e Shtetit eviton rastet e ndërhyrjeve nga të tjerët, si dhe merr masa për të ndaluar rastet e shpërdorimit të detyrës nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, duke favorizuar padrejtësisht ndonjërin nga palët.

9. Përmbartuesi gjyqësor, pas ekzekutimit të titujve ekzekutivë, përpilon procesverbalin për ekzekutimin pa probleme, të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në ekzekutim, si dhe përfaqësuesi i Policisë së Shtetit. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet përfaqësuesit të Policisë së Shtetit të pranishëm në ekzekutim.

10. Për çdo informacion të marrë gjatë ushtrimit të veprimtarisë, i cili mund të jetë me interes për strukturat e Policisë së Shtetit, përmbartuesit gjyqësorë kanë detyrimin e ruajtjes së fshehtësisë në raport me të tretët, përveç strukturave të Policisë së Shtetit, organit të prokurorisë apo gjykatës.

11. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTRI I DREJTËSISË
Brikena Kasmi

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 27.6.2011
Doli nga shtypi më 29.6.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë